



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 612/14 prot.

Datë 13.05.2024

V E N D I M
Nr. 501/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.05.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 428/2024, datë 26.04.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-92051-12-22-2023, me objekt: Loti 2: “Blerje Naftë (Eurodiesel)”, me fond limit 278,832,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA, me adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë ekonomikë “A & T” SHA (me NIPT L32320008H) & “2A2F – L OIL” SHPK (me NIPT L41915013M) & “Gega Center GKG” SHPK (me NIPT K66801001T) dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower”, Kati 7, Apartamenti 3, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Resuli - ER” SHA (me NIPT L12510413V) & “Kastrati” SHPK (me NIPT K21711502V) dhe adresë: Lagja 14, Rruga “Tiranës”, Ura e “Dajlanit”, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 26.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 428/2024, datë 26.04.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-92051-12-22-2023, me objekt: Loti 2: “Blerje Naftë (Eurodiesel)”, me fond limit 278,832,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A & T” SHA & “2A2F-L OIL” SHPK & “Gega Center GKG” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 18701/22 prot., datë 03.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 612/11 prot., datë 07.05.2024, autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 428/2024, datë 26.04.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-92051-12-22-2023,

me objekt: Loti 2: “Blerje Naftë (Eurodiesel)”, me fond limit 278,832,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 18701/22 prot., datë 03.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 612/11 prot., datë 07.05.2024, autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 428/2024, datë 26.04.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-92051-12-22-2023, me objekt: Loti 2: “Blerje Naftë (Eurodiesel)”, me fond limit 278,832,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P. 428/2024, datë 26.04.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA, ka zbatuar vendimin K.P.P 428/2024, datë 26.04.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-92051-12-22-2023, me objekt: Loti 2: “Blerje Naftë (Eurodiesel)”, me fond limit 278,832,000 lekë

(pa tvsh), zhvilluar me datë 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

